



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:068789

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417071

P.nr.114/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Latifi, në lëndën penale kundër të pandehurit S... B... nga fshati P..., dhe M... A..., nga fsh.Pasjan,Komuna e Parteshit, për shkak të veprës penale, sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.142/2024, të datës 27.02.2024, kërkesës për dhënien e urdhrorit ndëshkimor , PP.II.nr.142/2024, të datës 27.02.2024, ndërsa më datën 05.03.2024 mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor ndaj të pandehurit **S... B...** , nga babai V..., i lindur me datë ..., në Gjilan , me vendbanim në fshatin Pasjan, komuna e Parteshit, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal ..,serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

M... A... nga babai M,i lindur me date ... ne Vraje,R.S...e,me vendbanim ne fsh.P... Komuna e Parteshit,i martuar i pa pune, i gjendjes se varfer ekonomike,me nu,mer personal ..,shtetas i R.Kosoves,

JANE FAJTOR

I

Sepse me datë 01.Janar 2024 rreth orës 03:02 min, në kafiterinë Diablo fshatin Pasjan, komuna e Parteshit, i pandehuri S... B..., me dashje dhe me përdorimin e atë çastshëm të dhunës, e ka sulmuar të pandehurin tani të dëmtuarin M... A..... , ashtu që pas një mosmarrëveshje në mes vete , i pandehuri shkon te banaku ku ka qenë duke punuar i dëmtuari Milosh Antiq dhe të njëjtin e sulmon duke e goditur me grushta në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit , kështu që i pandehuri me veprimet e tija, tek i dëmtuari ka shkaktuar dhembje, mundim, frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-me çka ka kryer veprën penale, **Sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.**

II

I pandehuri M... A...me date 01.janar 2024 ,reth ores 03.20 min,ne kafiterin “ Diablo” ne fshatin Pasjan,Komuna e Parteshit,i pandehuri M... A....,me perdorimin e ateqashem te dhunes,me dashje i ka shkaktuar lendime trupore te pandehurit tani te damtuarit Srdjan Bujiq,ashtu qe per shkak te Sulmit te ber ndaj tij ashtu siq eshte pershkruar ne dispozitivin e pare,i pandehuri e ka kapun per fyti te demtuarin dhe e ka shtyer per tia nxjerr nga lokali mirpo i demtuari persri tenton qe te hyj ne lokal dhe ateher i pandehuri me te dy duart e shtyn te njejtin dhe nga kjo shtyrje i demtuari rrexohet per toke duke u perplasur ne nje tavoline,keshtu qe i pandehuri me veprimet e tij,i ka shkaktuar lendime te lehta trupore te demtuarit Sergjan Bujiq i cili per shkak te natyres se lendimeve eshte detyruar te kerkoj ndihme mjeksore ne QE ne Gjilan,

Me qka ka kryer vepren penale,Lendim i leht trupor nga neni 185 par.4 lidhur me paragrafin 1,nenparagrafin 1.4 te KPRK-es,

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4,17, 38, 43, 45, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 493 dhe 495 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **njëqinde pedhjet (150) euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita pasuese kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit S.... B.... nga fshati P..., Komuna e Parteshit, për shkak të veprës penale, sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit S... B..., dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet nga Raporti i informues i incidentit me numër 2024-CP-1 të datës 16.01.2024, deklaratat e të pandehurit M.. A, deklaratat e të dëmtuarit Srgjan Bujiq, deklaratat e dëshmitarëve raporti i oficerit, fotografi, raporti mjekësor me numër 39 i datës 01.01.2024, ekspertiza mjeko ligjore e datës 26. Shkurt 2024, foto-dokumentacioni si dhe shkresa të tjera që ndodhen në dosjen e lëndës vërtetojnë se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në bazë të shkresave të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri Srgjan Bujiq nga fshati Pasjan, Komuna e Parteshit, për shkak të veprës penale, sulm nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr. 114/2024, Më 05.03.2024

Gjyqtari vetëm gjykues,
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.